



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 972/3 Prot.

Elbasan më 25.9. 2025

Lënda: Kthim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.77 datë 29.08.2025 “Për përfshirjen në listën e familjeve që përfitojnë nga programet e strehimit”, vlerësojmë se përgjigja nga ana juaj është e paplotë referuar dokumentacionit të kërkuar nga ne për përfshirjen në një nga programet sociale të strehimit bazuar në Ligjin Nr. 22/2018 Për strehimin Social (ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, datë 22.6.2023), Neni 13, Kushtet për fitimin e statusit të përfituesit nga programet sociale të strehimit, për Z.Revi Bujar Vreto.

Sa më sipër aktin tuaj e kthejmë si të pabazuar në ligj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 82 / Prot.

Elbasan më 15 . 9 . 2025

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.77 datë 29.08.2025 “Për përfshirjen në listën e familjeve që përfitojnë nga programet e strehimit”, para se të shprehemi mbi ligjshmërinë e tij kërkojmë nga ju të na sillni të dhënat e mëposhtme:

Referuar Ligjit Nr. 22/2018 “Për strehimin social” (ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, datë 22.6.2023), Neni 13, Kushtet për fitimin e statusit të përfituesit nga programet sociale të strehimit, për Z. Revi Bujar Vreto na dërgoni informacion ku të jenë përfshirë të gjithë elementët sipas përcaktimeve të sipërcituara.

Në këto kushte deri në dërgimin e të dhënave të lartpërmedura, akti juaj mbetet i pakonfirmuar.

PREFEKTI
Ili BEJTJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHË
KESHILLI BASHKIAK

Librazhd, 19.09.2025

Nr 6407 Prot.

LËNDA : Mbi ligjshmërinë e aktit nr.77, datë 15.09.2025

DREJTUAR : PREFEKTIT TË QARKUT ELBASAN

Të nderuar,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.972/1 prot, datë 15.09.2025 ju informojmë si më poshtë vijon :

Me anë të këtij vendimi të këshillit bashkiak nuk është vendosur miratimi në program strehimi i familjes së Revi Vreto **por thjesht përfshirja në listën e familjeve që mund të përfitojnë në të ardhmen nga programet e strehimit.**

Kjo pasi secili program strehimi bazuar në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social” ka dokumentacion, procedure dhe afate të ndryshme. Shpallja e programeve të strehimit kryhet në momente të ndryshme duke përcaktuar edhe kriteret për aplikim.

Ky vendim nuk ka pasoja juridike për përfitimin e ndonjë programi strehimi por vetem përfshirjen në listën e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e strehimit.

Falemindërit për mirëkuptimin,

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ELSON MALLUTA






REPUBLICA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.02.09.2025

Nr.5918 prot

Nr.77 dt.29.08.2025

“PËR PËRFSHIRJEN NË LISTËN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET E STREHIMIT”

Këshilli I Bashkisë Librazhd, bazuar në Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar, Ligjin nr.22/2018 “Për strehimin Social”, si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, bazuar në funksionet dhe kopetencat, në mbledhjen e datës 29.08.2025.

VENDOSI:

1. Përfshirjen në listën e familjeve që përfitojnë nga programet e strehimit familjen e z.Revi Bujar Vreto;
2. Bashkia Librazhd të trajtojë me prioritet këtë familje në llojet programeve të strehimit që shpall sipas parashikimeve ligjore;
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori I Strehimit në Bashkinë Librazhd.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU

